



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:036002

Datë: 08.10.2018

Numri i dokumentit: 00141139

P.nr. 653/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN/ Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Fatmire Sermaxhaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit L.M. me vendbanim në fshatin ... K. ..., për shkak të veprës penale në vazhdimsi Lidhja e paautorizuar në shërbime, nga neni 321 lidhur me nenin 81 të KPRK-s, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.Nr.1018/2017 të datës 27.06.2017, të cilën e përfaqëson prokurori Shefik Memeti pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 03.10.2018 mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri L.M., nga babai Sh. e ëma N. e lindur B., i lindur ... në fshatin ... ku dhe jeton, Lagja e ..., ka të kryer shkollën e mesme, pa punësuar-invalid jeton me shtesa për invalid në shumë prej 75 euro., i martuar-baba i 6 fëmijëve, i gjendjes ekonomike të mesme, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

Sepse prej datës së pavërtetuar më datë 29.05.2017 në shtëpinë e tij në fshatin ...-Lagja e ..., i pandehuri si shfrytëzues i energjisë elektrike, me qëllim që vetit ti sjell përfitim të kundërligjshëm pasuror, është lidhur në mënyrë të pa autorizuar në rrjetin e energjisë elektrike, në kundërshtim me Ligjin për Energjinë Elektrike ka shfrytëzuar në mënyrë të pa autorizuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që pas vërtetimit të gjendjes faktike, tek shtëpia e të pandehurit nga ekipi i kontrollës e KEDS është konstatuar se pas konfiskimit të njehsorit për shkak të mos pagesës së borxhit, i pandehuri në mënyrë të pa autorizuar përmes një kablloje është lidhur direkt në rrjetin e energjisë elektrike, ashtu që energjia e shpenzuar përmes lidhjes direkte nuk është regjistruar dhe në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta në vazhdimsi ka shpenzuar energjinë elektrike të pa faturuar duke e dëmtuar KEDS-in Distrikti në Gjilan në shumë prej rreth 56 euro.

Me çka ka kryer veprën penale në vazhdimi Lidhja e paautorizuar në shërbime, nga neni 321 lidhur me nenin 81 të KPRK-s.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 50, 51, 73 dhe 75 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarit i shqipton

DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarit L.M., i caktohet dënimi kumulativ me burg në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditë, dhe dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, dënime të cilat nuk do të ekzekutohen, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të udhëzohet në kontest juridiko civil.

I pandehuri për shkak të gjendjes ekonomike të varfër, në bazë të nenit 453 paragrafi 4 të KPP lirohet nga shpenzimet procedurale.

ARSYETIM

1. Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 27.06.2017, ka ngritur aktakuzën PP.II.Nr.1018/2017, kundër të akuzuarit L.M., me vendbanim në fshatin ... K. ..., për shkak të veprës penale në vazhdimi Lidhja e paautorizuar në shërbime, nga neni 321 lidhur me nenin 81 të KPRK-s.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik të datës 03.10.2018 prezent ishin prokurori i shtetit Shefik Memeti, dhe i pandehuri L.M., në të cilën seancë i pandehuri pas leximit të aktakuzë nga ana e Prokurorit deklaroi se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale..

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit L.M., për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar as i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj vepre, ekziston fakti se i pandehuri L.M. ka kryer veprën penale, në vazhdimi Lidhja e paautorizuar në shërbime, nga neni 321 lidhur me nenin 81 të KPRK-s, në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, ka shpallur fajtor të akuzuarin L.M. për shkak të veprës penale, në vazhdimi Lidhja e paautorizuar në shërbime, nga neni 321 lidhur me nenin 81 të KPRK-s, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjës.

Në bazë të nenin 321 të KPRK-së Lidhja e paautorizuar në shërbime konsiderohet:

Kushdo që lidhet apo rilidhet në përqjes të rrymës apo në rrjetin për përcim ose shpërndarje të çfarëdo shërbimi komunal në çfarëdo mënyre, drejtpërdrejt apo tërthorazi, qoftë përmes përqjesshmërisë ose induksionit, pa autorizim të furnizuesit të autorizuar, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe të njëjtit ti shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve dhe dënim me gjobë në shumën prej 200 euro, dënime të cilat nuk do të ekzekutohen, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë penale të njëjtë apo tjetër, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që për të akuzuarin L.M. si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, dhe se i njëjti është penduar, më parë nuk ka qenë i dënuar dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti dëmin e shkaktuar të dëmtuarës dhe se kjo veprë penale kryhet vetëm me dashje.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit L.M., duke marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-s, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest juridiko civil.

8. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar nën 453 paragrafi 4 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta liroj nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale,

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 653/2017, Me datë 03.10.2018

Sekretarja Juridike
Fatmire Sermaxhaj d.v

Gjyqtari
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE; Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.